



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në vazhdimin e parë të seancës së pesëdhjetë e tetë të mbajtur më 28.12.2021 miratoi

Vendim

Procedura për lëndën me nr. 08-4352 / 1 datë 30.10.2021, NDËRPRITET.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-4352/1 datë 30.10.2021.

Lënda me numër 08 -4352/1 të datës 30.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-4352 / 1 të datës 30.10.2021 është formuar me iniciativë të saj.

Nga mbikëqyrja e evidencave të saj, KSHPK-ja ka konstatoi se personi _____ nuk ka dorëzuar flet anketuese në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në afatin e paraparë me ligj prej 30 ditësh pas zgjedhjes për zëvendës drejtor të _____.

KSHPK-ja përgatiti raport për kundërvajtje dhe urdhërpagesën e konstatuar dhe të njëjtën ia ka dorëzuar personit _____. Më datë 17.12.2021 ka paguar gjobën në shumën e shënuar në urdhërpagesë për kundërvajtje.

KSHPK, pas shqyrtimit të lëndës, konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtejshëm kompetent në rastin konkret.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. Nikolina Tarçullovska-Miloshevska, këshilltare
Miratoi: Nuri Bajrami, anëtar

КОМИСИОНИ ШТЕТЌОРОР
ПЃР PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
КРЈЕТАР,
Biljana Ivanovska

